




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASENIT LUMOR SHKUMBIN



VENDIM

Nr.7, datë 31.10.2025

PËR

**MIRATIMIN E LEJES PËR PËRDORIM BURIMI UJOR NËNTOKËSOR
PËR QËLLIME INDUSTRIALE, TË SUBJEKTIT “TEVI PLAST”
SH.P.K., ME VENDNDODHJE: NJ. ADM BRADASHESH, BASHKIA
ELBASAN.**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 141, të ligjit nr.29/2024, “Për Burimet Ujore”, i ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.319, datë 11.06.2025, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për përdorim burimi ujqor, dokumenteve shoqëruese, procedurës së shqyrtimit e vendimmarrjes, formateve të lejes, autorizimit, kushteve të posaçme dhe afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujqore, Këshilli Basenit Lumor Shkumbin,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për leje për përdorim burimi ujqor nëntokësor për qëllime industriale, të subjektit “TEVI PLAST” sh.p.k., me vendndodhje: Nj. Adm Bradashesh, Bashkia Elbasan.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e burimit ujqor:

- X= 502567.430
- Y= 4550189.231
- Z= 89 m



Sasia e ujit që jepet në përdorim : $Q = 0.8$ l/sek

- Qëllimi i përdorimit : Industriale, për ftohje në procesin e riciklimit dhe për larje të mbetjeve plastike.
- Thellësia e pus-shpimit: 41 m
- Thellësia e vendosjes së pompës : 39 m
- Koordinatat e pikës së shkarkimit (KRGJSH)

$X = 502560.23$;

$Y = 4550111.43$;

$Z = 89$ m

- Prurja që shkarkohet: $Q = 0.0868$ l/sek

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

KRYETARI I KBL SHKUMBIN

ILIR BEJTJA

